



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

01-2139

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës nr. 05-350/02-0236302/18 dt. 27.09.2018 të pronarit Valdet Shaqiri, nga Skenderaj – për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesorë, për ndërtimin e ndërtesës afariste buzë rrugës Prishtinë-Fushë Kosovë, në kuadër të PZHU-së në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 06.02.2019, merr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore pronarit, Valdet Shaqiri nga Skenderaj, sipas kërkesës nr. 05-350/02-0236302/18 dt.27.09.2019 për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e ndërtesës, afariste me etazhitet 2B+S+2, buzë rrugës Prishtinë-Fushë Kosovë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 01528-2 dhe 01528-10 Zona Kadastrale Prishtinë, të përfshira në Zonën Ekonomike të Planit Zhvillimor Urban.

II. Lokacioni i parcelës kadastrale të lartcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të Planit Zhvillimor Urban, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr.035-181427 dt. 24.09.2013, dhe kjo zonë është e planifikuar me destinim “Zonë ekonomike”.
Pronari me "Informim nga "PZHU", me referencë. 04-350-48381/18 dt.17.03.2015, lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm e Komunës së Prishtinës.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelave kadastrale, është:
 - nr. 01528-2 me S= 1500 m² dhe nr.01528-10 me S=2890m²(gjithësejt 4390 m²) me pronar Valdet Shaqiri, “tokë bujqësore e klasit të II-të”;
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe çertifikatës së njësisë kadastrale;
- Në parcelën kadastrale, për të cilën caktohen këto kushte të ndërtimit ekzistonë një pjesë e njërës nga dy depot me etazhitet P+0, të cilat kanë ekzistuar më parë në këtë parcelë;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni ka një pjerrtësi në drejtim lindje - perendim ;
- Parcela kadastrale ka qasje në rrugën ekzistuese nacionale N9,drejtimi Prishtinë-Fushë Kosovë.
- Në diametër prej 50 m' ka ndërtesa të ndërtuara dhe destinimi i tyre është afarizëm.

Faqe 1 prej 6

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin – ndërtimin e ndërtesës afariste, bazuar në parametrat urban të planit, janë:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës kadastrale, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelave, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit, bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës, sipas planit zhvillimor, të jetë për afarizëm.
- Etazhiteti sipas PZHU-së nuk është i përcaktuar, kurse i propozuar dhe i miratuar është 2B+S+P+2;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore- brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë-gabarit të përdhësës ose suterren, është max.40% dhe është:
$$\text{ISHP} \dots\dots\dots S = 4390 \text{ m}^2 \times 0.4 = 1756.00 \text{ m}^2$$
- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) sipas PZHU-së, nuk është i përcaktuar. Bazuar në projekt propozimin, koeficientin e shfrytëzimit të parcelës dhe etazhitetin e miratuar, (2B+S+P+2) ai do të jetë sipas pikës 3 dhe 4 të paragrafit IV të kushteve ndërtimore dhe praktikave të miratuara nga planet tjera urbane dhe është :
$$\text{ISPN} \dots\dots\dots S = (1756 \text{ m}^2 / 2) + (1756 \text{ m}^2 \times 3) = 878 \text{ m}^2 + 5268 \text{ m}^2 = 6146.00 \text{ m}^2$$
- Koeficienti ndërtimor i parcelës kadastrale, do të llogaritet si në vijim: 100% për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , 50% për etazhet me vëllim mbi 51% mbi tokë-suterren, dhe 0% për etazhet e nëntokës-bodrumë;
- Bazuar në kriteret e PZHU-së, distanca minimale në mes dy ndërtesave është $1.0 \times H - 1.50 \times H$, kurse distanca minimale nga kufiri i parcelës kadastrale - parcelës ndërtimore, është $0.5 \times H - 0.75 \times H$, ku H është lartësia e ndërtesës.
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për nëntokë (ISHPN) për vendosjen e ndërtesës në bazë – gabariti i bodrumit, lejohet max = 60% dhe kjo sipërfaqe është:
$$S = 4390 \text{ m}^2 \times 0.6 = 4390 \text{ m}^2 \times 0.6 = 2,634.00 \text{ m}^2$$
, për një nivel të bodrumit.
Sipërfaqja e përgjithshme e nëntokës sipas projekt propozimit për dy nivele të bodrumit-nëntokës është $2,278.00 \times 2 = 4,556.00 \text{ m}^2$.
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2015 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të shfrytëzimit eficient të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Qasja në parcelën e propozuar për ndërtim, të jetë prej rrugës ekzistuese, sipas planit të situacionit (pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Infrastrukturës)
- Në kuadër të parcelës të planifikohen edhe rrugë qarkulluese – perimetrike, për qasje të zjarrfikësve, si dhe shtigje, sipërfaqe të pllakëzuara, gjelbrim dhe vendëparkime të mjaftueshme për personel dhe klientë.
- Për ndërtesën afariste, mvarësishtë prej veprimtarisë së ngushtë, duhet të planifikohen vendparkingje sipas "Normave teknike të planifikimit hapësinor".
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet destinimit të ndërtesës së planifikuar;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore.
- **Para aplikimit për Leje ndërtimore, duhet të zhvendost linja e tensionit të lartë 110kV, L.P. 112/1 NS. Kosova A – NS. Lipjan, nga ajrore në atë kablloviqe në bazë të kushteve nga "kostt"- shkresa nr. 221 dt. 16.03.2016.**



- Pëlqimi nga "kostt" për distancën e lejuar për ndërtim, prej kabllit nëntokësor (të zhvendosur) deri te ndërtesa e planifikuar për ndërtim.
- Para aplikimit për Leje ndërtimore, duhet të aplikoni për "Leje të rrënimt" për demolimin e pjesës së depos ekzistuese në terren.
- Të sigurohet pëlqimi për qasje sipas "Planit të situacionit" në rrugën nacionale N9, Prishtinë – Fushë Kosovë
- Në fazën e aplikimit për Leje ndërtimore të lirohet prona nga hipoteka ose të sigurohet pëlqimi prej bankës.
- Pëlqimi i notrizuar i parcelës fqinje P-71914059-01528-9 për distancën e propozuar të ndërtesës. (Pëlqimi i është bashkangjitur dokumentacionit në fazën e aplikimit për kushte ndërtimore , LRP nr.684/2016, dt.07.03.2016 tek noteri Faton R. Muslija.)

V. **Bashkimi/** i parcelës kadastrale nr. 01528-2 dhe 01528-10 Zona Kadastrale, Prishtinë., do të realizohet sipas zgjidhjes urbane, të miratuar me këto kushte ndërtimore, përcaktuar me manualin e bashkimit të parcelave, punuar nga gjeodeti i licencuar.

Kjo drejtori përmes këtij paragrafi të vendimit të kushteve ndërtimore jep PËLQIM për bashkimin e parcelave kadastrale të lartëcekura, sipas zgjidhjes urbane. Procedura e bashkimit, do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve. Procedura e bashkimit të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarit duke u bazuar në Planin e situacionit - "Zgjidhjen Urbane".

V. **Kyçja në infrastrukturë** - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"-Ngrohitorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

VII. **Hartimi i dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor**, të bëhet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV. dhe V. Dokumentacioni ndërtimor duhet të dorëzohet në tri (3) kopje fizike dhe një (1) digjitale, dhe duhet të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;

- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdheshë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5,1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë, me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore
- Paramasën dhe parallogarinë e punëve ndërtimore;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me sinjalizime përkatëse të komunikacionit dhe lidhja-qasja e saj me rrugët dhe komplekset në rrethinë, etj.;
- Projektin e strukturës së ndërtimit-llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionimin dhe detajet e nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektrike, me përcaktimin e vendit për kyçe në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve hidroteknike, me përcaktimin e vendit për kyçe në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçe në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01nr.035-174324 dt.12.07.2016, e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore (akustika, termika, masat për efikasitet të energjisë);
- Elaboratin gjeomekanik, në bazë të analizave të terrenit;
- Elaboratin për mbrojtje nga zjarri;

VII. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore - meqenëse parcelat kadastrale nr. 01528-2 dhe 01528-10 Zona Kadastrale Prishtinë, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, janë të evidentuara me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit të "II-të", kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Planit të situacionit – "zgjdhja urbane", dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej S=4390 m². Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

VI. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të aplikuesit.



VII. Pagesa e taksës administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullores mbi Taksën Administrative për dhënie e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

X. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

Ar sy e t i m

Aplikuesi **Valdet Shaqiri** nga Skenderaj, me kërkesën nr. 05-350/02-0236302/18 dt. 27.09.2018 ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit Kryesor, për ndërtimin e ndërtesës afariste me etazhitet 2B+S+P+1, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Bashkangjitur me kërkesë, pronari ka prezantuar:

- Kopjen e planit për parcelat kadastrale nr.01528-10 dhe 01528-2 të evidentuara në certifikatat e njësisë kadastrale : P-71914059-01528-10 ; P-71914059-01528-2, ZK, Prishtinë.
- Kopjen e letërnjoftimit të Valdet Shaqirit:
- Kopjen e letërnjoftimit të Afrim Kukaj:
- Pëlqimin nga Fatmir Zymberi, përfaqësues ligjor/pronar i N.T.P ”SCAN COLOR” përkatesisht njësisë kadastrale P-71914059-01528-9, që fqiu z.Valdet(Avdyl) Shaqiri të ndertojë objekt të ndërtimit të lartë në njësitë kadastrale me nr:P-71914059-01528-10 dhe P-71914059-01528-2 dhe atë deri në kufi të parcelës, me LRP nr.684/2016, dt.07.03.2016 tek noteri Faton R. Muslija.
- Përgjigjen nga KOST-i për zhvendosjen e linjes së tensionit të lartë 110kv, LP.112/1 NS.Kosova A-NS.Lipjan. me nr.221 dt.16.03.2016.
- Vertetimin e tatimit në pronë të Valdet Shaqirit me nr.236282/18 dt.27.09.2018.
- Informatën nga PZHU me referencë 04-350-48381/18 dt.17.03.2015 përmes “Qendres për shërbim me qytetarë”.
- Inçizimi gjeodezik nga “GEOMATIKA-ARCH” SH.P.K.
- Çertifikata e regjistrimit të biznesit “GEOMATIKA-ARCH” SH.P.K me nr. të biznesit.810043878.
- Projekti ideor i objektit afatrist 2B+S+P+2 e punuar nga “GEOMATIKA-ARCH” SH.P.K.
- Vendimin-pëlqimin e Ministrisë së Infrastrukturës nr.9941 dt.19.10.2018 për Luxuri Invest sh.p.k me nr. Biznesi 810110635 ga Fushë Kosova për kryerjen e punëve në vendosjen e infrastrukturës nëntokësore (depërtim I rrugës – vendosje e kabllor energjetike 110kV), në rrugën Nacionale N9, drejtimi Prishtinë –Fushë Kosovë.

Me shkresën, nr. 05-350/02-0236302/18 dt. 27.09.2018 për “Plotësim dokumentacioni” është kërkuar nga aplikuesi, Inçizimi gjeodezik i largpërquesve në projeksion horizontal sipas gjendjes ekzistuese, dhe propozimi për ç’vendosje në bazë të rekomandimeve KOST-it. Këto plotësime janë dorëzuar me dt.22.11.2018.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 05-350/02-0236302/18 dt. 27.09.2018, dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve

të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni, PZHU-së, rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, projektit konceptual, bazuar në nenin 13, pika 1.2 të UA të MMPH-së Nr. 06/2017 dt.23.05.2017, ka vendosur njoftimin me datë 11.01.2019. Ky njoftim publik, sipas rregullativës ligjore, ka qëndruar pesë 15 ditë në lokacionin në fjalë dhe meqë ndërkohë kjo drejtori nuk ka pranuar ndonjë vërejtje apo sygjerim, është vazhduar me procedurën për caktimin e kushteve ndërtimore.

Bazuar në konstatimet e më sipërme, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L- 110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 7 dhe 8 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve”, Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se aplikuesi ka prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se projekti konceptual i prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të PZHU-së për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i situacionit -"zgjdhja urbane”,

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

I dërgohet: Aplikuesit, Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, në dosje të lëndës, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 Nr. 350/02 - 0236302/18 dt. 06.02.2019**

Zyrtari,
Mejrushe Sejdullahu



u.d Udhëheqëse e Sektorit,
Lindita Beqiri

